




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.329/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Euro Asphalt” - Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE: “Benita Company” - Klinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi – Asfaltimi i rrugës në fshatin Lugbunar – kontratë tri vjeçare”, me numër të prokurimit: 632/18/2792/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë, më datë: 01.08.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, siebazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Euro Asphalt” - Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi – Asfaltimi i rrugës në fshatin Lugbunar – kontratë tri vjeçare”, me numër të prokurimit: 632/18/2792/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Ndërtimi – Asfaltimi i rrugës në fshatin Lugbunar – kontratë tri vjeçare”, me numër të prokurimit: 632/18/2792/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Euro Asphalt” - Gjakovë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:14.05.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt:06.06.2018, ku kanë marrë pjesë shtatë (7) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik:“Euro Asphalt” - Gjakovë, tenderues i pasuksesshëm nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt:21.06.2018.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatorët ekonomik: “Euro Asphalt” - Gjakovë, me dt: 26.06.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 29.06.2018,Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik:“Euro Asphalt” - Gjakovë,si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues:“Euro Asphalt” - Gjakovë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 06 Korrik 2018, me nr.329/18, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Ndërtimi – Asfaltimi i rrugës në fshatin Lugbunar – kontratë tri vjeçare”, me numër të prokurimit: 632/18/2792/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet:7, 59, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 11.07.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 23.07.2018, fillimisht sqaron:

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues, se deklarata nën betim dhe formulari i tenderit nuk është nënshkruar nga drejtori i kompanisë por nga menaxheri dhe sipas pretendimit të OE ankues, OE i rekomanduar për kontratë është përgjegjshëm me arsyetimin se në ofertën e tij nuk ka dorëzuar autorizimin sipas nenit 18.3 të RrUOPP-se. Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se dy dokumentet e lartpërmendura të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, deklaratën nën betim dhe formularin e tenderit i ka nënshkruar Emin Demaku – Menaxher. Në certifikatën e biznesit OE “Benita Company”, bashkëpronar janë: Nexhat Kalludra dhe Hesen Kalludra. Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim sqaron se është i paqëndrueshëm për faktin se në nenin 18.3 të Rregullores dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik thuhet: *“...Në rast se personi që nënshkruan dhe dorëzon ofertën nuk është personi kompetent për nënshkrim të ofertës (drejtori i kompanisë), por është i autorizuar nga OE, OE duhet që të dorëzojë me ofertën e tij autorizimin për nënshkrimin e ofertës, përndryshe oferta e tij do të refuzohet. **AK obligohet që këtë kërkesë ta përcaktojë në DT**”.*

Eksperti shqyrtues pasi ka ekzaminuar kërkesat e dosjes së tenderit sqaron se AK-ja, nuk e ka përcaktuar si kërkesë të DT-se autorizimin e lartpërmendur, andaj duke u bazuar në paragrafin 3 të nenit 18 të RrUOPP-se, ky pretendim është i paqëndrueshëm. Poashtu është i paqëndrueshëm pretendimi ankimorë i OE ankues, që ka të bëjë me, mos vendosjen e simbolit (€) të valutës euro, në pjesën e paralogarise dhe paramasës së ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, për faktin se në formularin e tenderit e ka dhënë çmimin në euro, me numra dhe shkronja në euro dhe poashtu të pjesa e paramasës dhe paralogariste, është shënuar – çmimi për njësi me TVSH - €. Sa i përket pretendimit të OE ankues, në lidhje me makinerinë e OE të rekomandimit, për të cilin pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën për tre (3) kamionë kiper.

Eksperti shqyrtues, pasi ka ekzaminuar ofertën e të rekomanduarit për kontratë, sqaron se në ofertë i ka dorëzuar dy libreza – kamion kiper, pra sipas kërkesës. Në follder të AK-se gjenden disa verifikime të bëra për kokat tërheqëse të cilat i ka dorëzuar i rekomanduari për kontratë, për të cilat AK-ja pretendon se janë të njëjta. Eksperti shqyrtues është dashur të verifikojë dhe njëherit ti kërkojë sqarim me të detajuar për kokat tërheqëse. Andaj ky pretendim është pjesërisht i qëndrueshëm. Në vazhdim, sa i përket pretendimit në lidhje me licencën për baze të asfaltit të dorëzuar në ofertën e të rekomanduarit për kontratë, kërkesë kjo e dosjes së tenderit, ku ankuesi pretendon se OE i rekomanduar për kontratë “Benita Company” i cili në ofertën e tij e ka dorëzuar një marrëveshje për furnizim me asfalt me OE “Bes Group”.

Ankuesi pretendon se furnizuesi i prezantuar ne marrëveshje “Bes Group”, nuk ka licence për baze asfalti nga Komisioni i pavarura për Miniera dhe Minerale.

Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim fillimisht sqaron se, OE i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tij e ka dorëzuar një marrëveshje për furnizim me asfalt me OE “Bes Group”, ndersa licencën për baze asfalti e ka dorëzuar te OE “AHN Group” dhe ne ofertën e tij i ka bashkangjitur dy dokumente, ku njeri është vërtetim i Agjensionit te regjistrimit te bizneseve ne Kosove, ne te cilin thuhet se “AHN Group” me datën: 07.07.2017, ka ndryshuar emërtimin dhe tani është “Bes Group”. Ndërsa dokumenti tjetër është një deklaratë me shkrim e pronarit te kompanisë “Bes Group”, i cili ka deklaruar se “Kuvendi i aksionareve me datën: 11.04.2017, ka vendosur ndryshimin e emrit te kompanisë nga “AHN Group” ne “Bes Group”.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se sipas kërkesës se dosjes se tenderit është dashur qe OE i rekomanduar për kontrate te dorëzoje/dëshmojë me licencën ne emër te OE “Bes Group”, sepse ne kërkesën e dosjes se tenderit thuhet: ...kontratë nga një ndërmarrje e licencuar nga KPMM-ja.

Për te sqaruar me ne detaje kërkesën e dosjes se tenderit eksperti shqyrtues me date: 20.07.2018, ka kërkuar sqarim me shkrim nga KPMM-ja, lidhur me licencën për baze te asfaltit te OE “Bes Group”. Ne përgjigjen e datës: 23.07.2018, KPMM-ja, deklaroi se: “Ndërmarrja “Bes Group” shpk me nr.70537362 me adrese nga KK- Gllogoc, nuk posedon Leje te Aktivitetit te veçante – te Bazës se Asfaltit ne baze te dhënave qe posedon KPMM”.Eksperti shqyrtues, sa i përket kërkesës se dosjes se tenderit lidhur me licencën për baze asfalti, ne fund vlerëson se OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar këtë kërkesë te dosjes se tenderit dhe njëherit sqaroi se nuk qëndron arsyetimi i AK-se, se i njëjti e ka ndërruar emrin, për faktin se ndërrimi i emrit ka te beje me certifikatën e biznesit ku i njëjti, pra OE “Bes Group” është dashur qe ta ndërroj dhe te dëshmoj se e ka edhe licencën e bazës se asfaltit te OE “Bes Group”, sipas kërkesës se dosjes se tenderit, sepse vlerësimi i ofertave nga AK-ja, duhet te behet konform nenit 59.4 te LPP-se, ku thuhet se AK-ja do ta konsideroj te përgjegjshëm vetëm ofertën e cila është ne përputhje te plot me kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate. Gjithashtu sipas deklaratës me shkrim te pronarit te OE “Bes Group”, operator me emrin “AHN Group” nuk ekziston qe nga data 11.04.2017.

Ne fund te analizimit dhe shqyrtimit te pretendimeve ankimore eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues ne lidhje me licencën për baze te asfaltit te OE te rekomanduar për kontrate është i qëndrueshëm për faktin se kërkesën ne lidhje me këtë kërkesën i rekomanduari nuk e ka plotësuar, andaj me këtë rast siç është sqaruar edhe me lart, nuk është respektuar neni 59 i LPP-se.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet pjesërisht si e bazuar, për faktin se disa pretendime ankimore te OE ankues nuk qëndrojnë, ndërsa njoftimi për dhënie të kontratës të anulohet dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues – Komuna Gjakovë, me datë: 26.07.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues – Komuna Gjakovë, me datë: 26.07.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 01.08.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE z.Deva deklaroj: Lidhur me kundërshtimin tonë nuk kisha me ashtu më shumë se mendimi që ka dhënë eksperti, pra pajtohem plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues. Do kërkoja që me që OE i shpallur fitues të anulohet ai vendim sikurse ka thënë eksperti dhe lënda të shkoj në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së znj.Bakalli deklaroj: Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës nuk Pajtohet me mendimin e ekspertit për kthim te lendes ne ri-vlerësim. Sa i përket pretendimit se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kriterin për tre (3) kamion kiper, eksperti ka sqaruar se është deshtë të kërkohej sqarime shtesë.Komisioni i vlerësimit ka kërkuar sqarime shtesë dhe në bazë të sqarimeve që ka dëshmuar OE i rekomanduar për kontratë OE i ka plotësuar kriterin e

kërkuar në FDT dhe në Njoftim për kontratë. Sa përket -Pretendimi të OE ankues “Euroasphalt”, se OE i rekomanduar për kontratë ka prezentuar licensat/lejet e lëshuar nga KPMM-ja , mirëpo marrëveshja apo kontrata e nënshkruar në mes të “BES Group” e shëndruar nga ish “AHN Group” iu është bashkangjitur licenca nga KPMM-ja për bazë të asfaltit. Me tu shëndruar ky biznes nga “AHN Group” në “Bes Group”-it , sepse edhe nr. i biznesit gjatë shëndrimit/ndryshimit të emrit të kompanisë ndryshojnë po edhe nr. fiskal, TVSH etj, ji sqarojmë si në vijim:SQARIM : Kompania Bes Group shpk ka dorëzuar vertetim të ARBK-së e nënshkruar dhe e protokulluar nga ARBK , e cila e verteton se biznesi i rexhistruar me datë 29/10/2008 me nr. të biznesit 70537362 “AHN Group” shpk me adres Arllat Drenas Miradi e Ulët me 19/04/2017 ka ndryshuar emertimin si “Bes Group” shpk si dhe adresen në Arllat Gllogovc. AHN Group Shpk, ka leje për aktivitet të veçant për bazë të asfaltit të vlefshme deri me 21/10/2018. Pretendimet e juaj se nr. i biznesit gjatë shëndrimit/ndryshimit të emrit të kompanisë ndryshojnë po edhe nr. fiskal, TVSH etj, janë të babazuara apo argumentuara për arsye se kompanija në fjalë ka ndryshuar vetem emrin e biznesit.Sa i përket pretendimit tuaj se në bazë të ligjit për Miniera dhe Minerale nr.03/L-163 Neni 10.2 si dhe neni 7 i këtij ligji, ju sqarojmë si në vijim: Neni 10, i ligjit të KPMM-së ka të bëjë me Transferimi dhe Lënia Peng e Licencave dhe Lejeve, me këtë rast pretendimi juaj është i pabazë, për arsye se “AHN Group” shpk me adres Arllat Drenas Miradi e Ulët me 19/04/2017 ka ndryshuar emertimin si “Bes Group” shpk si dhe adresen në Arllat Gllogovc dhe nuk ka të bëjë me Transferimi dhe Lënia Peng e Licencave dhe Lejeve. Ndërsa Neni 7, i të KPMM-së ka të bëjë me Procedurat e përgjithshme të KPMM-ja , ku sqaron se KPMM do të nxjerrë procedura dhe formularë standard për procedurën e aplikimit për licencë dhe për dhënien e Licencave dhe Lejeve, si dhe për zgjatjen, modifikimin, bartjen, pezullimin ose anulimin e tyre. Me sa u tha më lartë eksperti në mënyrë jo profesionale ka marrë të bazuar këtë pretendim pa e verifikuar ligji e KPMM. Dhe nuk ka ofruar asnjë argument se kompania në fjalë ka bërë Transferimi dhe Lënia Peng e Licencave dhe Lejeve, duke u bazuar në ligjit për Miniera dhe Minerale nr.03/L-163 Neni 10.2 si dhe neni 7 i këtij ligji. Me sa u tha më lartë kompania vetëm ka bërë ndryshim të emrit e biznesit dhe pyetje e OSHP-së drejtuar KPMM-së, nuk ka qenë adekuate pasi që baza e asfaltit egziston me emrin “AHN Group” me të njëjtin nr. të biznesit dhe me të njëjtin pronar. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës duke u bazuar dhe respektuar të gjitha ligjet në fuqi, propozon panelin shqyrtues që vendimi i AKK Gjakovë të mbetet në fuqi.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i shqyrtues z.Basha deklaroj: Çështja e KPMM, përfaqësuesi i AK deklaron se është dashtë në detyrë më të detajuar të kërkohet sqarim nga KPMM, mirëpo unë në cilësi të ekspertit të prokurimit nisem nga kërkesa e dosjes së tenderit, ku AK ka kërkuar licencë të lëshuar nga KPMM ose kontratë nga një ndërmarrje e licencuar në KPMM. Duke i nisur nga dëshmitë e ofruara në

ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, i njëjti ka marrëveshje për furnizim me asfalt me OE Bes Grup dhe për të njëjtin pra për OE Bes Ghrup kam kërkuar sqarim se a ka licencë apo nuk ka. Përgjigjja e KPMM ka qenë ajo që kam shënuar edhe në raport të ekspertizës se Bes Grup nuk ka licencë për bazë të asfaltit.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Deva deklaroj: I propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën tonë të bazuar dhe të kthehet lënda në rivlerësim.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK znj.Bakalli deklaroj: I propozojmë panelit shqyrtues të refuzoj ankesën të pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i AK.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton sesa i përket pretendimit të OE ankues, se deklarata nën betim dhe formulari i tenderit nuk është nënshkruar nga drejtori i kompanisë së operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës por nga menaxheri, po ashtu OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka dorëzuar autorizimin sipas nenit 18.3 të RrUOPP-se, lidhur me këtë paneli shqyrtues konstaton se dy dokumentet e lartpërmendura të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, deklaratën nën betim dhe formularin e tenderit i ka nënshkruar Emin Demaku – Menaxher. Në certifikatën e biznesit OE “Benita Company”, bashkëpronar janë: Nexhat Kalludra dhe Hesen Kalludra, andaj pretendimi i ankuesit është i pa qëndrueshëm për faktin se në nenin 18.3 të Rregullores dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik thuhet: *“...Në rast se personi që nënshkruan dhe dorëzon ofertën nuk është personi kompetent për nënshkrim të ofertës (drejtori i kompanisë), por është i autorizuar nga OE, OE duhet që të dorëzojë me ofertën e tij autorizimin për nënshkrimin e ofertës, përndryshe oferta e tij do të refuzohet. **AK obligohet që këtë kërkesë ta përcaktojë në DT**”*.

Paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues sqaron se AK-ja, nuk e ka përcaktuar si kërkesë të DT-se autorizimin e lartpërmendur, andaj duke u bazuar në paragrafin 3 të nenit 18 të RrUOPP-se, ky pretendim është i paqëndrueshëm. Po ashtu është i paqëndrueshëm pretendimi ankimorë i OE ankues, që ka të bëjë me, mos vendosjen e simbolit (€) të valutës euro, në pjesën e paralogarise dhe paramasës së ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, për faktin se në formularin e tenderit ky operator ekonomik e ka dhënë çmimin në euro, me numra dhe shkronja në euro dhe po ashtu

te pjesa e paramasës dhe parallogariste, është shënuar – çmimi për njësi me TVSH - €.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, në lidhje me makinerinë e OE të rekomandimit, për të cilin OE ankues pretendon se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e ka plotësuar kërkesën për tre (3) kamionë kiper, paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në konstatimet e ekspertit shqyrtues i cili ka ekzaminuar ofertën e OE të rekomanduarit për kontratë, sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës në ofertë i ka dorëzuar dy libreza – kamion kiper. Në follet të AK-se gjenden disa verifikime të bëra për kokat tërheqëse të cilat i ka dorëzuar i rekomanduari për kontratë, për të cilat AK-ja pretendon se janë të njëjta. Paneli shqyrtues konstaton se AK-ja, ka mundur të kërkojë sqarim operatorit ekonomik me të detajuar për kokat tërheqëse. Andaj ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i qëndrueshëm, andaj duke u nisur nga të cekurat si më lart paneli shqyrtues vlerëson se autoritetit kontraktues në pajtim me nenin 72 të LPP-së ka mundur të kërkojë sqarime nga ana e OE në fjalë për çfarëdo paqartësie lidhur me të cekurat si më lart.

Paneli shqyrtues sa i përket pretendimit të OE ankues në lidhje me licencën për baze të asfaltit të dorëzuar në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, kërkesë kjo e dosjes së tenderit, ku ankuesi pretendon se OE i rekomanduar për kontratë “Benita Company” i cili në ofertën e tij e ka dorëzuar një marrëveshje për furnizim me asfalt me OE “Bes Group”. Ankuesi pretendon se furnizuesi i prezantuar në marrëveshje “Bes Group”, nuk ka licence për baze asfalti nga Komisioni i pavarur për Miniera dhe Minerale, konstaton se, OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij e ka dorëzuar një marrëveshje për furnizim me asfalt me OE “Bes Group”, ndërsa licencën për baze asfalti e ka dorëzuar të OE “AHN Group” dhe në ofertën e tij i ka bashkangjitur dy dokumente, ku njëri është vërtetim i Agjensionit të regjistrimit të bizneseve në Kosovë, në të cilin thuhet se “AHN Group” me datën: 07.07.2017, ka ndryshuar emërtimin dhe tani është “Bes Group”. Ndërsa dokumenti tjetër është një deklaratë me shkrim e pronarit të kompanisë “Bes Group”, i cili ka deklaruar se “Kuvendi i aksionareve me datën: 11.04.2017, ka vendosur ndryshimin e emrit të kompanisë nga “AHN Group” në “Bes Group”, andaj paneli shqyrtues vlerëson se ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se sipas kërkesës së dosjes së tenderit është dashur që OE i rekomanduar për kontratë të dorëzojë/dëshmojë me licencën në emër të OE “Bes Group”, sepse në kërkesën e dosjes së tenderit thuhet: ...kontratë nga një ndërmarrje e licencuar nga KPMM-ja.

Paneli shqyrtues sqaron se për të sqaruar më në detaje kërkesën e dosjes së tenderit eksperti shqyrtues me datë: 20.07.2018, ka kërkuar sqarim me shkrim nga KPMM-ja, lidhur me licencën për baze të asfaltit të

OE "Bes Group". Ne përgjigjen e datës: 23.07.2018, KPMM-ja, deklaroi se: "Ndërmarrja "Bes Group" shpk me nr.70537362 me adrese nga KK- Glllogoc, nuk posedon Leje te Aktivitetit te veçante – te Bazës se Asfaltit ne baze te dhënave qe posedon KPMM". Paneli shqyrtues duke u bazuar ne te cekurat si me lart konstaton se sa i përket kërkesës se dosjes se tenderit lidhur me licencën për baze asfalti, OE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar këtë kërkesë te dosjes se tenderit dhe njëherit sqarojmë se nuk qëndron arsyetimi i AK-se, se i njëjti e ka ndërruar emrin, për faktin se ndërrimi i emrit ka te beje me certifikatën e biznesit ku i njëjti, pra OE "Bes Group" është dashur qe ta ndërroj dhe te dëshmoj se e ka edhe licencën e bazës se asfaltit te OE "Bes Group", sipas kërkesës se dosjes se tenderit, sepse vlerësimi i ofertave nga AK-ja, duhet te behet konform nenit 59.4 te LPP-se, ku thuhet se AK-ja do ta konsideroje te përgjegjshëm vetëm ofertën e cila është ne përputhje te plot me kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate. Gjithashtu sipas deklaratës me shkrim te pronarit te OE "Bes Group", operator me emrin "AHN Group" nuk ekziston qe nga data 11.04.2017.

Paneli shqyrtues konstaton se me rastin evlerësimit krahasimit dhe ekzaminimit te ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë autoritet kontraktues nuk ka vepruar ne pajtim me nenin 59 të LPP-se.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z.Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK -Komuna Gjakovë

1x1 OE -"Euro Asphalt" - Gjakovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.